

Deutsche Bundesbank
Heislitz
2003
Zyra e Marëdhënieve Evropiane

Frankfurt am Main, 17. Janar

☎ 21 65

Rruga e Shqipërisë drejt Euros

1. Hyrje

Sipas nenit 49 të Traktatit për Bashkimin Evropian, “Çdo shtet evropian mund të aplikojë për t’u bërë anëtar i Bashkimit”. Shtetet anëtare ekzistuese kanë vendosur disa kriterë ekonomike dhe politike (“Kriteret e Kopenhagenit”) që duhet të plotësohen nga kandidatët pas aplikimit. Këto kriterë, shkurtimisht dhe parimisht nënkuptojnë ekzistencën e një demokracie funksionuese lidhur me të drejtat e njeriut dhe ato të minoritetit, si dhe ekzistencën e një ekonomie tregu, e cila të jetë në gjendje të përballojë presionin e tregut në tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian. Përfundimisht, në një pikë kohore pas pranimit, shteti i ri anëtar do të zëvendësojë monedhën e tij kombëtare me euron dhe rrjedhimisht do të bëhet anëtar i Bashkimit Monetar Evropian.

Një vështrim në hartë tregon se Shqipëria është pikërisht një pjesë e kontinentit evropian. Kështu, ajo është e përshtatshme për të nisur rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe, së fundi, për futjen e euros. Në vazhdim, do të vihet në dukje rruga drejt këtij qëllimi përfundimtar nisur nga pikëpamja e një banke qendrore kombëtare (në të cilën do të ndodhet Banka e Shqipërisë në fazën përfundimtare pas futjes së euros).

Në këtë rrugë, mund të dallohen tre hapa:

1. Faza para pranimit.

2. Anëtarësim në Bashkimin Evropian, por ende jo në zonën e euros.
3. Anëtar i zonës së euros.

2. Faza para pranimit

Politika monetare dhe e kursit të këmbimit mbetet përgjegjësi kombëtare, parimisht, me mundësinë për të zgjedhur një sistem të kursit të këmbimit ndër disa alternativa dhe për të zgjedhur strategjinë e politikës monetare. Kjo është etapa në të cilën ndodhet Shqipëria aktualisht.

Me rritjen e integritimit në Bashkimin Evropian – marrëveshjet e partnershipit para-pranimit dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian – ndoshta një orientim në rritje drejt Bashkimit Evropian është i arsyeshëm. Kjo nënkupton, ndër të tjera, një orientim në rritje të politikës së kursit të këmbimit drejt euros.

Megjithatë, futja e njëanshme e euros shihet nga Eurosistemi (shihni pas pikës 5) sikur nuk është në përputhje me frymën e Traktatit, i cili parashikon futjen e euros si rezultat i një procesi shumëpalësh me një kontroll të konvergencës dhe një test nëse kursi i konvertimit është ai i duhuri.

3. Faza pas pranimit

Pas pranimit në Bashkimin Evropian, i cili mund të nënkuptojë veprim nga banka qendrore kombëtare (Banka e Shqipërisë) vetëm në mënyrë të kufizuar (liberalizim i kapitalit), Shqipëria do të jetë një anëtare me heqje të drejtë, domethënë, Shqipëria nuk do të bëhet menjëherë një anëtare e zonës së euros. Pasojat më të mëdha për Shqipërinë do të ishin:

- Do t'i duhej të drejtonte politikën e këmbimit valutor si një çështje të interesit të përbashkët (Neni 124 i Traktatit) gjë që do të përjashtonte për shembull, zhvlerësimet konkurruese.
- Do të pritej një futje në mekanizmin e kursit valutor (MKV), duke nënkuptuar kurse këmbimi fikse me euron me një vijë luhatjeje.
- Brenda mekanizmit të kursit valutor, do të përjashtoheshin sisteme të tjera të kursit valutor si fiksimi i vlerës së monedhës vendase (pegging) kundrejt monedhave të tjera, luhatjet fleksible apo vija e luhatjeve të axhustueshme kundrejt euros.

- Bordet për monedhën janë një rast i veçantë dhe një pjesëmarrje në mekanizmin e kursit valutor do të ishte e mundur pas ekzaminimit të secilit rast të veçantë.

4. Futja e euros

Anëtarësimi në zonën e euros, që nënkupton futjen e euros si monedhë vendase, do të ndiqte zbatimin e kritereve të njëjta si për anëtarët aktualë. Ato përfshijnë një normë maksimale të inflacionit dhe norma interesi maksimale në vitin para ekzaminimit, një gjendje buxhetore të përballueshme dhe dy vjet anëtarësim në mekanizmin e kursit valutor.

Madje, pavarësia e bankës qendrore kombëtare është e nevojshme. Qëndrimi i Eurosistemit është që këto kritere duhet të zbatohen në mënyrë rigorozë.

5. Funksionimi i zonës së euros

Duke shqyrtuar Bashkimin Evropian sot, ne mund të shohim që ajo përfshin 15 shtete anëtare, nga të cilat 12 marrin pjesë në bashkimin monetar. Tre vende nuk marrin pjesë (ende). Megjithatë, sipas Traktatit, të gjitha bankat qendrore kombëtare të 15 shteteve anëtare (BQK) marrin pjesë në të ashtuquajturin “Sistem Evropian i Bankave Qëndrore”, por jo në “Eurosistem”. Duke filluar me “Eurosistemin”, një shprehje që nuk gjendet në Traktat, ai përfshin Bankën Qendrore Evropiane dhe Bankën Qendrore Kombëtare e atyre vendeve, që kanë futur euron si monedhën e tyre. Ky është i vetmi aktor që ka rëndësi. Ekziston vetëm SEBQ, pak a shumë, shprehur me shkrim për arsye politike.

5.1 Kuadri institucional

Si SEBQ ashtu edhe Eurosistemi drejtohen nga organe vendim-marrëse të Bankës Qendrore Evropiane, megjithatë SEBQ ka vetëm “ekzistencë fantazmë”.

Organi i përgjithshëm i vendim-marrjes është Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Evropiane. Ai përfshin Këshillin Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane (më hollësisht në paragrafin tjetër) dhe guvernatorët e Bankave Qendrore Kombëtare pjesëmarrëse. Përgjegjësitë kryesore të tij janë:

- Të formulojë politikën monetare të zonës së euros.
- Të miratojë udhëzime dhe të marrë vendime të nevojshme për të kryer detyrat e besuara.

- Të ketë funksion konsultativ, siç parashtrohet në nenin 105, paragrafi 4 i Traktatit, në fushën ku ai ka fuqi ligjore.

Këshilli Ekzekutiv i Bankës Qendrore Evropiane përfshin Presidentin, Zëvendës-presidentin e Bankës Qendrore Evropiane dhe katër anëtarët e tjerë. Ai është në të vërtetë bordi qendror i zonës së euros dhe është përgjegjës për:

- Biznesin përditshëm të Bankës Qendrore Evropiane dhe veçanërisht për përgatitjen e takimeve të Këshillit Drejtues.
- Implementimin e politikës monetare veçanërisht të vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues.

Delegimi i pushteteve nga Këshilli Drejtues në Këshillin Ekzekutiv është i mundshëm.

Në qoftë se dhe për aq kohë sa ka shtete anëtare me heqje të drejte, Këshilli i Përgjithshëm do të përbëjë organin e tretë të vendimmarrjes së Bankës Qendrore Evropiane (Neni 123, paragrafi 3 i Traktatit). Ai përfshin Presidentin, Zëvendës-presidentin e Bankës Qendrore Evropiane dhe guvernatorët e gjithë Bankave Qendrore Kombëtare. E shprehur shkurtimisht, ai ka detyra tranzitore të cilat, për shkak të heqjes së të drejtë së shteteve anëtare, ende duhet të kryhen në etapen e tretë. Rëndësia e tij mund të matet me faktin që Këshilli Drejtues takohet çdo dy javë dhe Këshilli i Përgjithshëm çdo tre muaj.

Duke u kthyer në funksionimin e Eurosistemit, Këshilli Drejtues, siç është shprehur deri tani, përbën organin më të lartë vendimmarrës. Puna e tij ndihmohet nga 13 komitete¹. Këto komitete mandatohen nga Këshilli Drejtues dhe raportojnë nëpërmjet Këshillit Ekzekutiv përsëri pranë Këshillit Drejtues. Duke përjashtuar politikën monetare, rëndësia e tyre nuk duhet të nënvlerësohet. Ata përgatisin pothuajse të gjitha vendimet teknike të Këshillit Drejtues.

Për lidhjet ndërmjet Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankave Qendrore Kombëtare ekziston një parim drejtues: Banka Qendrore Evropiane (domethënë, Këshilli Drejtues) merr vendimet, Bankat Qendrore Kombëtare i implementojnë ato. Banka e Shqipërisë do të jetë një ndër bankat qendrore kombëtare në të ardhmen. Ndërkohë Bankat Qendrore Kombëtare janë pjesë integrale e SEBQ-së sipas Traktatit. Në të vërtetë thuhet: (Eurosistemi) dhe veprojnë në përputhje me

¹ Për të ardhurat monetare dhe kontabile, mbikëqyrjen bankare, kartmonedhat, buxhetin, komunikimet e jashtme, teknologjinë dhe informacionin, kontrollin e brendshëm, lidhjet ndërkombëtare, ligjore, operacionet e tregut, politikën monetare, sistemet e pagesave dhe likuidimit, statistikat.

udhëzimet e Bankës Qendrore Evropiane. Ato janë të vetmet të cilat janë në kontakt me tregjet dhe me institucionet e kreditit. Duke folur në mënyrë të figurshme, Banka Qendrore Evropiane është koka që përgatit vendimet e Këshillit Drejtues ndërsa Bankat Qendrore Kombëtare janë trupi që realizojnë vendimet e marra në kokë (parimisht nga Këshilli Drejtues).

5.2 Shpërndarja e detyrave

Shpërndarja e detyrave ndërmjet qendrës dhe shteteve anëtare mund të përcaktohet si vijon:

BQE (Këshilli Drejtues):

- Të formulojë politikën monetare.
- Të specifikojë kuadrin rregullativ, organizativ dhe logjistik të Eurosistemit.
- Të autorizojë emetimin e kartëmonedhave.
- Të nxjerrë akte ligjore (rregullore, rekomandime, vendime).
- Të ofrojë këshillim ndaj institucioneve dhe organeve përkatëse.
- Të përgatisë dhe të drejtojë raportin vjetor për aktivitetet e Eurosistemit dhe të politikës monetare.

Bankat Qendrore Kombëtare:

- Të implementojë politikën monetare të veçantë.
- Të administrojë aktivat e rezervave valutore të Bankës Qendrore Evropiane.
- Të realizojë operacione në aktivat e rezervës valutore që mbeten me Bankat Qendrore Kombëtare.
- Të kryejë funksione të ndryshme nga ato të përcaktuara në Traktat, të cilat i jepen bankës qendrore kombëtare nga ligji kombëtar.

Nga sa më sipër del se Bankat Qendrore Kombëtare janë të domosdoshme për funksionimin e bashkimit monetar në të tashmen dhe në të ardhmen e afërt. Ekzekutimi i politikës monetare vetëm nga Banka Qendrore Evropiane nuk do të ishte i menaxhueshëm, nisur nga ndryshimet në strukturat e tregjeve financiare

kombëtare dhe veçanërisht atyre bankare. Ndërsa, në Holandë, për shembull, janë vetëm pesë lojtarë të rëndësishëm, në Gjermani, janë rreth 2700 banka. Përveç diferencave strukturore, sigurisht që ka edhe diferenca të përgjithshme kulturore dhe gjuhësore ndërmjet shteteve anëtare. Këto arsye veprojnë në favor të anulimit të ndonjë centralizimi të mëtejshëm në një të ardhme pak a shumë të largët.

Lidhur me rolin e një banke qendrore kombëtare në Eurosistem, dallimi kryesor është ndërmjet funksioneve të kryera për Eurosistemin dhe atyre të kryera për llogari të vet, duke mos u lidhur me të. Detyrat kryesore në lidhje me Eurosistemin janë:

- Të implementojë transaksionet refinancuese me institucionet e kreditit.
- Të administrojë rezervat minimale.
- Të kryejë operacionet valutore për Bankën Qendrore Evropiane me rezervat e veta (Banka Qendrore Evropiane nuk kryen operacione të këmbimit valutore).
- Të drejtojë një sistem pagesash në vlerë të madhe përtej kufirit ("TARGET") dhe të nxisë funksionimin e rregullt të sistemeve të pagesave.
- Të shpërndajë arkën.
- Të ndërtojë marrëdhënit me publikun në gjuhën kombëtare.
- Të këshillojë qeverinë në fushën e politikës monetare
- Të grumbullojë të dhëna të veçanta.

Këta shembuj u morën nga detyrat që kryen Deutsche Bundesbank. Ato do t'i ngjani shumë atyre të Bankave Qendrore Kombëtare në bashkimin monetar. Në rastin e Deutsche Bundesbank-ut disa detyra mbeten jo të lidhura siç duhet me bashkimin evropian, por lejohen nga Eurosistemi për aq kohë sa ato nuk çrregullojnë politikën monetare. Ato janë:

- Veprimi si agjent fiskal për qeverinë kombëtare.
- Pjesëmarrja në mbikëqyrjen bankare.
- Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë.
- Bashkëpunimi teknik i bankës qendrore.

- Administrimi i rezervave të pensioneve të qeverisë federale.
- Organi i ankesave të klientëve jashtë gjykatës për pagesa transfertë përtej kufirit.

5.3 Lidhja ndërmjet Banka Qendrore Evropiane dhe Bankat Qendrore Kombëtare

Së fundi, duhet të përmendet se Banka Qendrore Evropiane zotërohet nga Bankat Qendrore Kombëtare dhe mund të konsiderohej si një “degë”. Neni 29 i Statutit të SEBQ parashtron se pjesa e përqindjes së Bankave Qendrore Kombëtare në kapitalin e Bankës Qendrore Evropiane duhet të jetë e barabartë me shumën e :

- 50 për qind të pjesës së shteteve përkatëse anëtare në popullsinë e Komunitetit në 1997; dhe
- 50 për qind e pjesës së shteteve përkatëse anëtare në produktin e përgjithshëm bruto të Komunitetit me çmime tregu në vitet 1992-1996.

Këto shifra rishikohen normalisht çdo 5 vjet.

Rrjedhimisht, Bankat Qendrore Kombëtare janë aksionere të Bankës Qendrore Evropiane, duke nënkuptuar selinë qendrore në Frankfurt, që përfshin stafin dhe Këshillin Ekzekutiv të saj – që është, sigurisht, i pavarur. Buxheti vjetor i Bankës Qendrore Evropiane paraqitet çdo vit për vendim nga Këshilli Drejtues.

